



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 98/22

Nr. i fq. / Br. sh. -1-

Data: / Datum 28.04.2022

VUSHTRRI - VUČITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**


Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" në lidhje me nenin 17, shkronja "s" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, si dhe nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë **28 prill 2022**, merr këtë:

**VENDIM**

**PËR LIRIMIN NGA PAGESA E TAKSËS PËR KIOSKA**

1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës komunale, kioskat nga druri që jepen në shfrytëzim nga komuna për më pak se një vit, nga data 1.5.2022 deri më 25.4.2023.
2. Qëllim i këtij vendimi është përkrahja e këtyre veprimtarive, të cilat operojnë në gjendje jo të mirë ekonomike.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Drejtoria e Inspektimeve.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

  
Kryesuese e Kuvendit





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 99/22

Nr. i fq. / Br. st. -1-

Data: / Datum 28.04.2022

VUSHTRRI - VUČITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” në lidhje me nenin 17, paragrafi 1, shkronja “s” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, si dhe nenin 41, paragrafi 2, shkronja “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë **28 prill 2022**, merr këtë:

**VENDIM  
PËR RITJEN E VLERËS SË TARIFËS PËR SHËRBIMET E VARRIMIT**

1. Me këtë vendim rritet vlera e tarifës për shërbimet e varrimit, në shpenzimet komunale për ritet fetare që ofrohen nga Bashkësia Islame Dega në Vushtrri, nga 180 € sa është aktualisht në 200 €.
2. Rritja prej njëzet (20 €) e vlerës së kësaj tarifës bëhet si rezultat i rëndimit të gjendjes së përgjithshme ekonomike, në kushtet e ngritjes së çmimeve dhe shtrenjtimit të kostos së jetesës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**  
  
**Kryesuese e Kuvendit**





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSH TRRISË - OPŠTINA VUČITRAN

DI No. / Br. 101/22

No. i fq. / Br. sh. - 1 -

Data / Datum 28.04.2022

VEHICULES - VUČITRAN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" në lidhje me nenin 17, paragrafi 1, shkronja "s" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, si dhe nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 28 prill 2022, merr këtë:

**VENDIM**

**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VERIFIKIMIN E PROCESIT TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE**

1. Me këtë vendim formohet komisioni kuvendar për verifikimin e procesit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, identifikimin e pronave që janë të uzurpuara, si dhe verifikimi i shfrytëzimit të parcelave private ku janë ndërtuar objektet ndërtimore- banesore - kolektive dhe objektet tjera në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën kohore 1999-2022, në përbërjen si në vijim:

- 1.1 Zojë Hajrizi, anëtare e kuvendit (PDK);
- 1.2 Agron Përçuku, anëtar i kuvendit (LDK);
- 1.3 Shkelzen Xhaferi, anëtar i kuvendit (LDK);
- 1.4 Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit (LVV) dhe
- 1.5 Bekim Zabërgja anëtar i kuvendit Nisma Socialdemokrate.

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi në takimin e parë, në përbërjen e tij duhet të zgjedhë kryesuesin e komisionit dhe procesmbajtësin, dhe pas verifikimit të këtij procesi duhet të hartojë raport me shkrim lidhur me të gjeturat në terren dhe të njëjtin duhet të t'ia adresojë Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

  
Kryesuese e Kuvendit

